



Nr prot. 119 Date 29.6.24

UNIVERSITY OF NEW YORK, TIRANA

TIRANË DREJTORIA E PËRGJITHSHME

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

RREGULLATORE PËR ARSIMIN DHE SPORTIN

Nr. 2577/3 Prot.

Tiranë, më 19.6.2024

Lënda: Dërgohet urdhri për njohje dhe zbatim

**AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë

**QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE**

Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr. 23, Tiranë

**UNIVERSITETIT NEW YORK TË TIRANËS**

Adresa: Rruga e Kavajës, Pranë 21 Dhjetorit (Sheshi Ataturk), Tiranë ✓

Bashkëlidhur gjeni për njohje dhe zbatim urdhrin nr.288, datë 12.06.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Gjuhë dhe Letërsi Turke", në Universitetin e New York-ut në Tiranë".

Duke ju falënderuar,

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**Erzen Tola**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 2577/2 Prot.

Tiranë, më 12.06.2024

URDHËR

NR. 288, DATË 12.06.2024.

PËR

HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR NË  
"GJUHË DHE LETËRSI TURKE", NË UNIVERSITETIN E NEW YORK-UT NË  
TIRANË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 73, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe shkronjës "g", të pikës 2, të urdhrit nr. 113, datë 26.03.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Ana Kapaj", i ndryshuar.

URDHËROJ:

- Hapjen e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Gjuhë dhe Letërsi Turke", me 180 kredite dhe kohëzgjatje 3 vite akademike (6 semestra), në gjuhën shqipe, angleze dhe turke, me formë studimi me kohë të plotë, me kod 63BA0232SAX. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë "Bachelor" në "Gjuhë dhe Letërsi Turke", në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore, në Universitetin e New York-ut në Tiranë, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
- Veprimtaria akademike në programin e studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Gjuhë dhe Letërsi Turke", në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore, në Universitetin e New York-ut në Tiranë, fillon sipas legjislacionit në fuqi.
- Universiteti i New York-ut në Tiranë, të marrë masa që programi i studimit t'i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
- Universiteti i New York-ut në Tiranë, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtatë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.

5. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri. Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti i New York-ut në Tiranë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ANA KAPAJ

